



**AKT THEMELIMI
"ALWADI" SHPK**

Z.Hamza Mohammad Abdelkarim Aburayyan dhe Z.Mohammed Ali Mohammed Obadi, te angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë 17.01.2022, shprehin vullnetin dhe angazhimin e tyre për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.

Emri i shoqërisë do të jetë "ALWADI" SHPK, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortakët e shoqërisë.

- **Z.Hamza Mohammad Abdelkarim Aburayyan**, i datëlindjes 25.07.1963, lindur në Jordani dhe banues në Tiranë, Rr. "Mine Peza", Nr.102, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. Personal G33725003B.
- **Z.Mohammed Ali Mohammed Obadi**, i datëlindjes 02.05.1983, lindur në YEM dhe banues në Tiranë, Rr."Kavajës", Pll 24, Ap 17, Kat-4, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. Personal I305022385.

3. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Agjensi Turistike, Menaxhim të ambienteve turistike, Rent Car, Import-Eksport të Automejeteve, Shit-Blerje të Automjeteve, Hoteleri, Siguracione, Shërbim Shëndetësor, etj.**

Shoqëria mund të kryej çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

4. Sella e shoqërisë.

- Sella e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 4, Zyra A/1, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Kapitali themeltar.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 Lekë** (njqind mije).
- Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota.
- Ortaku Hamza Mohammad Abdelkarim Aburayyan, do të zotëroj 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë ose **50 000 Lekë** (pesëdhjetë mijë lekë).
- Ortaku Mohammed Ali Mohammed Obadi, do të zotëroj 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë ose **50 000 Lekë** (pesëdhjetë mijë lekë).

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori.

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është **Z. Hamza Mohammad Abdelkarim Aburayyan**.

9. Likuidimi i shoqërisë.

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKET E SHOQËRISË

Hamza Mohammad Abdelkarim Aburayyan



Mohammed Ali Mohammed Obadi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ARDJANA A. MEDIU



V2022050620023014861

DATE 17/01/2022
NR REP 287

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 17.01.2022 (dy mijë e njëzet e dy), para meje Notere Ardjana A. Mediu, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Blv."Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESIT:

Z.Hamza Mohammad Abdelkarim Aburayyan, atësia Mohammad, amësia Aysheh, shtetas Shqiptar, lindur në JORDANI, Jordani (JOR) dhe banues në Tiranë, me adresë Mine Peza; Nd. 2; H. 1; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 25/07/1963, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 254511 dhe nr. personal G30725254E.

Z.Mohammed Ali Mohammed Obadi, atësia Ali, amësia Fadliah Yahya, shtetas shqiptar, lindur në Ibb, Jemen (YEM) dhe banues në TIRANË, me adresë Sulejman Pasha; Nd. 24; H. 1; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 02/05/1983, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035995872 dhe nr. personal I30502238S.

Te cilet, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Akt themelimi "ALWADI" Shpk date 17.01.2022", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

ARDJANA A. MEDIU

